



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

VENDIM
K.P.P. 277/2021

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 11.06.2021 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Shfuqizim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në lidhje me kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “V.A.L.E Recycling” SHPK në procedurën e prokurimit me nr. REF-90182-03-17-2021, Loti 1 me objekt “Instrumente të mprehta” me fond limit 7.852.000,00 lekë pa TVSH zhvilluar në datën 26.04.2021 nga Drejtoria e Spitalit Rajonal, Lezhë.

Ankimues: “Medi-Tel” SHPK
Autostrada Tiranë Durrës, KM 1, Rr “Vidhe Gjata” Nr.18

Autoriteti Kontraktor: Drejtoria e Spitalit Rajonal, Lezhë
Lagja: “Varosh” Lezhë

Subjekti i interesuar: “V.A.L.E Recycling” SHPK
Lezhë, Fushë Kuqe GUREZ Fshatin Gurëz, afer ish-Kanalit të Acidit

Baza Ligjore: Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik, Neni

4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Vlerësimi paraprak

1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar;

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar.

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 18.03.2021 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit me nr. REF-90182-03-17-2021, Loti 1 me objekt “Instrumente të mprehta” me fond limit 7.852.000,00 lekë pa TVSH zhvilluar në datën 26.04.2021 nga Drejtoria e Spitalit Rajonal, Lezhë.

II.2. Në datën 26.04.2021 autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit objekt ankimi.

II.3. Në datën 06.05.2021 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezultoi si më poshtë vijon:

-	“V.A.L.E Recycling” SHPK	5 642 000	lekë	I kualifikuar
-	“Medi-Tel” SHPK	5 890 300	lekë	I kualifikuar

II.4. Në datën 12.05.2021 operatori ekonomik “Medi-Tel” SHPK ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor lidhur me kualifikimin e ofertës së operatorëve ekonomik “V.A.L.E Recycling” SHPK me argumentet si më poshtë:

[...] 2.1 Drejtoria e Spitalit Rajonal Lezhe ka publikuar ne adresen e www.app.gov.al procedurën e prokurimit PROCEDURE E HAPUR SHERBIME me Objekt i kontrates: "Evadimi i mbetjeve te rrezikshme spitalore", ndare ne lote, gjithsej 3 lote - Marreveshje Kuader me disa operatore ekonomikë (nje OE te vetem te suksesshem per secilin lot)- ku te gjitha kushtet jane te percaktuara - me afat 24 muaj", Numri i references se procedures: REF-90180-03-17-2021, Fondi limit: 9,664,000.00 (nente milion e gjashteqind e gjashtedhete e kater mije) leke pa TVSH dhe Afati kohor per dorezimin e ofertave ose kerkesave per pjesemarrje: Data: 26/04/2021, Ora: 09:00.

2.2 Operatori ekonomik Medi-Tel SHPK ka marre pjese ne kete procedure tenderimi publikuar ne adresen e www.app.gov.al, procedurën e PROCEDURE E HAPUR SHERBIME me Objekt i kontrates: "Evadimi i mbetjeve te rrezikshme spitalore", ndare në lote, gjithsej 3 lote - Marrëveshje Kuader me disa operatore ekonomikë (një OE të vetem të suksesshem per secilin lot)- ku të gjitha kushtet janë përcaktuara - me afat 24 muaj", Numri i references se procedures: REF-90180-03-17-2021, Fondi limit: 9,664,000.00 (nente milion e gjashteqind e gjashtedhete e kater mije) leke pa TVSH, -por nga shqyrtimi vleresimit të tenderit "Evadimi i mbetjeve te rrezikshme spitalore", ndare ne lote, gjithsej 3 lote - Marreveshje Kuader me disa operatorë ekonomik (nje OE te vetem te suksesshem per secilin lot)- ku te gjitha kushtet jane te percaktuara - me afat 24 muaj" (Faza e vlersimit te ofertave) bere nga KVO Drejtoria e Spitalit Rajonal Lezhe ne faqen online www.app.gov.al jemi lajmeruar per renditjen e OE pjesemarres ne kete procedure, si me poshte:

LOTI 1 -Instrumentë te mprehta

Operatori Ekonomik	Vlerat te ofertave	Refuzuar	Arsye
V.A.L.E. RECYCLING	5642000	JO	Në zbatim të argumentimit të sjellë ne zbatim te nenit 561 te LPP eshtë kulifikuar si oferte e rregullt
MEDI-TEL	5890300	JO	

Nisur nga kjo renditje dhe vleresimit te ofertes se OE V.A.L.E. RECYCLING si oferte e vlefshme ju bejme me dije se:

AK ne Dokumentet Standardete Tenderit 3.3 Kapaciteti teknik, konkretisht Pika 12 e LOTIT 1, ka kerkuar:

Operatori duhet te furnizojë me kontenitore sipas standardeve dhe kerkesave te VKM Nr. 798 date 29.09.2010 "Per administrimin e mbetjeve spitalore" pika 8/4 dhe 8/5 te kreut III. Per te provuar plotesimin e ketij kriteri, operatori duhet te paraqese ne ambientet e SRL-se ne daten dhe oren e hapjes se tenderit nga nje moster te paketimeve:

a. Per mbetjet e mprehta Kontenitor Plastik me 1 perdorim (rreth 3 L dhe rreth 5L)_ loti 1

b. Per mbetjet me potencial infektues Kontenitor Kartoni me Qese te Verdhe me 1 perdorim (rreth 40L dhe rreth 60L)_ loti I

VETE AK KA KERKUAR QE KONTENITOR PLASTIK DHE KONTENITOR KARTONI TE JENE SIPAS STANDARTEVE DHE KERKESAVE TE VKM NR. 798 DATE 29.09.2010 "PER ADMINISTRIMIN E MBETJEVE SPITALORE" PIKA 8/4 DHE 8/5 TE KREUT III. Me konkretisht VKM Nr. 798 date 29.09.2010 "Per administrimin e mbetjeve spitalore" pika 8/4 dhe 8/5 të kreut III kerkon:

8.4 Mbetjet spitalore të rrezikshme ambalazhohen dhe etiketohen ne perputhje me shtojcën 2.A dhe magazinohen të ndara nga mbetjet e tjera.

8.5 Kur mbetjet spitalore duhet te transportohen per t'u trajtuar ne vend tjetër, magazinimi ne terren i tyre behet ne nje zone te caktuar ne brendesi apo ne afersi të vendeve të trajtimit, apo te pikave të nisjes, duke permbushur kerkesat e meposhtme:

a) Te lejohet hyrja vetem e personave që kane kualifikim per të administruar mbetje spitalore.

b) Te tregohet kujdes per sigurine e kontejnereve, te parandalohen rrjedhjet, te sigurohet mbrojtja nga uji, shiu dhe era, si dhe të shmangen kushtet e inkubimit mikrobik dhe ose te dekompozimit te tyre. Mbetjet njerezore, shtazore apo te ndonje gjallese tjetër të magazinuara per me shume se 24 ore, por gjithsesi me pak se 48 ore nga ambalazhimi, duhet të ruhen ne frigorifer ose hapësire frigoriferike që perdoret vetem per mbetjet spitalore ne nje temperature jo me të larte se 10°C.

c) Të jene ndertuar me materiale të qendrueshme dhe pa kende, që pastrohen lehtesisht, qe nuk lejojne depertimin e lengjeve dhe të jene rezistente ndaj paraziteve e agjenteve të tjere mjedisore. d) Te mbahen paster ne kushte të mira sanitare dhe ne gjendje te mire funksionale.

e) Mbetjet të jene të etiketuara ne menyre të dukshme me simbolin nderkombetar te biorrezikshmerise të paraqitur ne shtojcen 2.A dhe me njoftime të rrezikut ne dyer, porta ose mbulesa, frigorifere dhe kontejnere të tjere qe tregojne perdorimin e magazines per mbetje spitalore ku hyrja e personave të paautorizuar eshte e ndaluar.8213

f) Sistemet e kullimit të dyshemese së magazines duhet të mundesojne shkarkimet direkt ne një sistem kanalizimesh sanitare per asgjесimin e ujerave të ndotura, ne perputhje me ligjin

nr.9115, date 24.7.2003 "Per trajtimin mjedisor të ujerave të ndotura", ose ne një impiant grumbullimi qe parandalon derdhjen e lengjeve dhe renien në kontakt me mjedisin.

Pikerisht, Shtojca 2 e VKM Nr. 798 date 29.09.2010 " Për administrimin e mbetjeve spitalore", per te cilen AK ka kerkuar qe te respektohet mbi standardet e kontejnerëve do te shikojme se kontenitoret duhet te kene:

S

HTOJCA2

MODELI NDERKOMBËTAR I SINJALISTIKES QE NJOFTON RREZIKUN E MBETJEVE SPITALORE DHE STANDARDI I ETIKETIMIT

SHTOJCA2.A

ETIKETA E KONTEJNITORËVE



Etiketa perfshin shenjen nderkombetare dalluese te rrezikut te mbetjes mjekesore, njoftimin e rrezikut mjekesor ne shqip dhe ne anglisht dhe numrin e pare te klasifikimit nderkombetar (6).Madhesia minimale e etiketes duhet te jete 14cm x 14cm dhe te kete formen e nje rombi.

SHTOJCA 2.B

ETIKETA E KOSHAVE

Te gjitha etiketat duhet te prodhohen me materiale qe u rezistojne rrezeve UV, ujit dhe te jene ngjitese.


Etiketa qe duhet te vendoset ne pjesen e prapme te koshit



Etiketa perfshin shenjen dalluese te rrezikut te mbetjes mjekesore nderkombetare, njoftimin e rrezikut te mbetjes mjekesore ne shqip dhe anglisht, dhe numrin e pare te klasifikimit nderkombetar (6): Madhësia minimale e etiketes duhet te jete 14cm x 14cm dhe te kete formen e nje rombi.

Etiketa qe duhet te vendoset ne pjesen e perparme te koshit

Etiketa dalluese duhet te percaktoje me germa te medha llojin e mbetjes se rrezikshme, pershkrimin shtese dhe duhet të mbajë shenjën dalluese të rrezikut. Madhësia minimale e etiketës duhet të jetë (gjerësi x lartësi) 14 cm x 5 cm. Etiketa duhet të jetë e shkruar në gjuhën shqipe dhe angleze.



Etiketa pershkruese perfshin:

- pershkrimin dhe identifikimin (me germa te bardha ne nje sfond te zi), "Mbetje spitalore•• N.O.S

- percaktimin - "Infektuese"
- fjalen sinjalizuese "RREZIK"
- njoftimin e rrezikshmerise "Mund te shkaktoje infeksion"

- Numri i OKB-se"3291"
- Klasen e rrezikut 6.2."
- Numrin e Katalogut Shqiptar te Klasifikimit te Mbetjeve" 18.01.03 *"
- Numrat EINECS²
- Shprehja e rrezikut"R21"
- Shprehja e sigurise "S1/4/24/35/36/37/431/60
- Deklarate paralajmeruese
- Identifikimi i furnizuesit
- Personi i kontaktit
- Adresa
- Numri i telefonit dhe celularit

- Madhësia minimale duhettëjetë (gjerësi x lartësi) 21 cm x 14 cm (A5). Etiketaduhettëjetë në gjuhën shqipe dhe angleze.



Infektuese
Infectious

Fjala sinjalizuese: RREZIK
Signalword: DANGER
Shprehja e rrezikshmerise: mund të shkaktoje infeksion
Hazard Statement: may cause infection

Nr. i UNI /-UN-Number: 3291
Klasa/Class: 6.2
Katalogu i Mbetjeve:
*Waste Catalogue: 18.01.03**
Nr. i EINECSI /EINECS Nr.:
R - Frasa I A-Phrase: R21
S - Frasa I S-Phrase: S1/4/24/35/36/37/431/60

Shprehja parandaluese / Precautionary Statement:
Identiteti i furnizuesit/Supplier
Identification: Personi i Kontaktit/
Contact Person:
Adresa/Address:
Numri i Telefonit/ Tel Number:

Etiketa e "Destinacionit dhe e Deklarimeve"

Cdo kosh i ambalazhuar, i mbyllur dhe vulosur, duhet të identifikohet me një etiketë që duhet të vendoset në unazën e vules dhe që tregon:

- Vendndodhjen;*
- Gjendjen e ngurte ose të lenget;*
- Llojin e mbetjes së rrezikshme;*
- Datën e grumbullimit;*
- Numrin e koshit ose ambalazhimit;*
- Sasinë në kg ose litra;*
- Nenshkrimin e punonjesit të grumbullimit.*

**Ne momentin e dorezimit te mostrave prane Spitalit Rajonal Lezhe me daten 26/04/2021 ora 09:00, jane paraqitur vetem dy Operatore, MEDI-TEL shpk dhe VALE Recycling. Nga ana e shoqerise :MEDI-TEL SHPK dorezimin e mostrave e ka bere Administratori i shoqerise z.Ervin Kristo, dhe ne prani te perfaqesueve te Spitalit si dhe te perfaqesuesit te shoqerise VALE Recycling, ka bere me dije se kontenitoret qe shoqeria VALE Recycling ka paraqitur per kete procedure nuk i permbushnin standardet/kerkesat e kerkuara ne DST pasi te gjitha kontenitoret nuk permbushin Piken 12 te LOTIT 1, te 3.3 Kapaciteti teknik pasi asnje nga keta kontenitore nuk kishte te stapunar ne gjuhen shqipe asnje etikete. Edhe kontenitoret qe kishin vetem njerem nga etiketat nuk e kishin sipas madhesis se kerkuar ne VKM 798 date 29.09.2010 dhe e ritheksojme se asnje etikete nuk ishte ne gjuhen SHQIPE kur VKM 798 date 29.09.2010 e kerkon qarte qe etiketat duhet te jene ne gjuhen SHQIP dhe ANGLISHT.*

i) Neni 2 te LPP qe percakton "Perzgjedhja e fituesve te kontratave publike realizohet ne perputhje me keto parime te pergjithshme:

a) mosdiskriminim dhe trajtim i barabarte i ofertuesve ose kandidateve;

b) transparence ne procedurat e prokurimit;

c) barazi ne trajtimin e kerkesave dhe te detyrimeve, qe u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve.

Gjithashtu, ne mbeshetje te VKM 798 date 29.09.2010, ju ngarkon per verifikim para konkluzionit grupit tuaj ne te dy operatoret per sa me siper, per plotesimin e kushteve dhe teknologjise. Mbrojtja e Mjedisit eshte primare dhe sipas porosive te fundit te Kryeministrit Z. Edi RAMA.

Duke qene brenda afateve ligjore po Ju drejtohem me ankese si Titullar i Autoritetit Kontraktor per te fituar te drejten tone per t'u kualifikuar.

Për sa më siper kerkojme:

- Pezullimin e procedures se prokurimit publik objekt ankimi dhe te shqyrtohet ankesa jone.

- Anullimin e Vendimit te Autoritetit Kontraktor, rivleresimin e Ofertes se OE V.A.L.E Recycling dhe skualifikimin e saj per lotin 1 te prokurimit publik per shkak se nuk ploteson DST.

- Shpalljen fitues te prokurimit publik per lotin 1, shoqerine Medi-Tel.sh.p.k.

Duke u bazuar ne sa me siper :

Lutemi qe ankesa jone te merret parasysht.

II.6. Në datën 14.05.2021 autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje operatorit ekonomik ankimues ku ka vendosur mospranimin e ankesës për pretendimet e operatorit ekonomik ankimues lidhur me kualifikimin e operatorit ekonomik “V.A.L.E Recycling” SHPK.

II.7. Në datën 20.05.2021 operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik duke pretenduar se: “Drejtoria e Spitalit Rajonal Lezhë ka publikuar në adresën e www.app.gov.al procedurën e prokurimit Procedurë e hapur, Shërbime me objekt :Loti 1-Instrumenta të mprehta” numri i referencës së procedurës: REF-90182-03-17-2021,

Fondi limit; 7.852.000.00 (shtatë milion e tetëqind e pesëdhjetë e dy mijë) lekë pa TVSH dhe afati kohor për dorëzimin e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje: Data 26/042021, ora 09:00. Operatori ekonomik Medi-Tel shpk ka marre pjese ne kete procedure tenderimi me objekt :Loti 1-Instrumenta të mprehta” numri i references së procedurës: REF-90182-03-17-2021, Fondi limit; 7.852.000.00(shtatë milion e tetëqind e pesëdhjetë e dy mijë) lekë pa TVSH

Sipas vlerësimit të bërë nga KVO Drejtoria e Spitalit Rajonal Lezhë në faqen online www.app.gov.al jemi lajmëruar për renditjen e OE pjesëmarrës në këtë procedure si më poshtë:

LOTI 1 -Instrumente te mprehta

Operatori Ekonomik	Vlerat te ofertave	Refuzuar
V.A.L.E. RECYCLING	5642000	JO
MEDI-TEL	5890300	JO

Nisur nga kjo renditje dhe vleresimit te ofertes se OE V.A.L.E. RECYCLING si oferte e vlefshme kemi ushtruar të drejtën tone të ankimit pranë Autoritetit Kontraktor depozituar pranë kësaj të fundit brenda afateve ligjore dhe nga ana e saj është kthyer përgjigje negative me anë të shkresës nr. 354/2 prot, datë 14.05.2021 duke mos pranuar ankesën tone.

Ne si shoqëri ofertuese nuk jemi dakort me kualifikimin e bere nga KVO dhe KSHA e AK për ofertuesin V.A.L.E Recycling për shkak se është absolutisht i pavlefshëm dhe në kundërshtim me ligjin dhe procedurën që parashikon legjislacioni për arsyet e mëposhtme:

AK ne Dokumentet Standardete Tenderit 3.3 Kapaciteti teknik, konkretisht Pika 12 e LOTIT 1, ka kerkuar:

Operatori duhet te furnizojë me kontenitore sipas standardeve dhe kërkesave të VKM Nr. 798 date 29.09.2010 "Per administrimin e mbetjeve spitalore" pika 8/4 dhe 8/5 te kreut III. Per te provuar plotesimin e ketij kriteri, operatori duhet te paraqese ne ambientet e SRL-se ne daten dhe oren e hapjes se tenderit nga nje moster te paketimeve:

a. Per mbetjet e mprehta Kontenitor Plastik me 1 perdorim (rreth 3 L dhe rreth 5L)_ loti 1

b. Per mbetjet me potencial infektues Kontenitor Kartoni me Qese te Verdhe me 1 perdorim (rreth 40L dhe rreth 60L)_ loti I

VETE AK KA KERKUAR QE KONTENITOR PLASTIK DHE KONTENITOR KARTONI TE JENE SIPAS STANDARDEVE DHE KERKESAVE TE VKM NR. 798 DATE 29.09.2010 "PER ADMINISTRIMIN E MBETJEVE SPITALORE" PIKA 8/4 DHE 8/5 TE KREUT III. Me konkretisht VKM Nr. 798 date 29.09.2010 "Per administrimin e mbetjeve spitalore" pika 8/4 dhe 8/5 të kreut III kerkon:

8.4 Mbetjet spitalore të rrezikshme ambalazhohen dhe etiketohen ne perputhje me shtojcen 2.A dhe magazinohen të ndara nga mbetjet e tjera.

8.5 Kur mbetjet spitalore duhet te transportohen per t'u trajtuar ne vend tjetër, magazinimi në terren i tyre behet ne nje zone te caktuar ne brendesi apo ne afersi të vendeve të trajtimit, apo te pikave të nisjes, duke permbushur kerkesat e meposhtme:

- a) Te lejohet hyrja vetem e personave që kane kualifikim per të administruar mbetje spitalore.
 - b) Te tregohet kujdes per sigurine e kontejnereve, te parandalohen rrjedhjet, te sigurohet mbrojtja nga uji, shiu dhe era, si dhe të shmangen kushtet e inkubimit mikrobik dhe ose te dekompozimit te tyre. Mbetjet njerezore, shtazore apo te ndonje gjallese tjetër të magazinuara per me shume se 24 ore, por gjithsesi me pak se 48 ore nga ambalazhimi, duhet të ruhen ne frigorifer ose hapësire frigoriferike që perdoret vetem per mbetjet spitalore ne nje temperature jo me të larte se 10°C.
 - c) Të jene ndertuar me materiale të qendrueshme dhe pa kende, që pastrohen lehtesisht, qe nuk lejojne depertimin e lengjeve dhe të jene rezistente ndaj parazitëve e agjenteve të tjere mjedisore.
 - d) Te mbahen paster ne kushte të mira sanitare dhe ne gjendje te mire funksionale.
 - e) Mbetjet të jene të etiketuara ne menyre të dukshme me simbolin nderkombetar te biorrezikshmerise të paraqitur ne shtojcen 2.A dhe me njoftime të rrezikut ne dyer, porta ose mbulesa, frigorifere dhe kontejnere të tjere qe tregojne perdorimin e magazines per mbetje spitalore ku hyrja e personave të paautorizuar eshte e ndaluar.8213
 - f) Sistemet e kullimit të dyshemese së magazines duhet të mundesojne shkarkimet direkt ne një sistem kanalizimesh sanitare per asgjесimin e ujerave të ndotura, ne perputhje me ligjin nr.9115, date 24.7.2003 "Per trajtimin mjedisor të ujerave të ndotura", ose ne një impiant grumbullimi qe parandalon derdhjen e lengjeve dhe renien në kontakt me mjedisin.
- Pikerisht, Shtojca 2 e VKM Nr. 798 date 29.09.2010 " Për administrimin e mbetjeve spitalore", per te cilen AK ka kerkuar qe te respektohet mbi standardet e kontejnereve do te shikojme se kontenitoret duhet te kene:

SHTOJCA2

MODELI NDERKOMBËTAR I SINJALISTIKES QE NJOFTON RREZIKUN E MBETJEVE SPITALORE DHE STANDARDI I ETIKETIMIT

SHTOJCA2.A

ETIKETA E KONTEJNITORËVE



Etiketa perfshin shenjen nderkombetare dalluese te rrezikut te mbetjes mjekesore, njoftimin e rrezikut mjekesor ne shqip dhe ne anglisht dhe numrin e pare te klasifikimit nderkombetar (6). Madhesia minimale e etiketes duhet te jete 14cm x 14cm dhe te kete formen e nje rombi.

SHTOJCA 2.B

ETIKETA E KOSHAVE

Te gjitha etiketat duhet te prodhohen me materiale qe u rezistojne rrezeve UV, ujit dhe te jene ngjitese.

Etiketa qe duhet te vendoset ne pjesen e prapme te koshit




Etiketa perfshin shenjen dalluese te rrezikut te mbetjes mjekesore nderkombetare, njoftimin e rrezikut te mbetjes mjekesore ne shqip dhe anglisht, dhe numrin e pare te klasifikimit nderkombetar (6). Madhesia minimale e etiketes duhet te jete 14cm x 14cm dhe te kete formen e nje rombi.

Etiketa qe duhet te vendoset ne pjesen e perparme te koshit

Etiketa dalluese duhet te percaktoje me germa te medha llojin e mbetjes se rrezikshme, pershkrimin shtese dhe duhet te mbajë shenjën dalluese të rrezikut. Madhësia minimale e etiketës duhet të jetë (gjerësi x lartësi) 14 cm x 5 cm. Etiketa duhet të jetë e shkruar në gjuhën shqipe dhe angleze.

Etiketa pershkruese perfshin:



- pershkrimin dhe identifikimin (me germa te bardha ne nje sfond te zi), "Mbetje spitalore N.O.S

- percaktimin - "Infektuese"
- fjalen sinjalizuese "RREZIK"
- njoftimin e rrezikshmerise "Mund te shkaktoje infeksion"
- Numri i OKB-se"3291"
- Klasen e rrezikut 6.2."
- Numrin e Katalogut Shqiptar te Klasifikimit te Mbetjeve" 18.01.03 *"
- Numrat EINECS²
- Shprehja e rrezikut"R21"
- Shprehja e sigurise "S1/4/24/35/36/37/431/60"
- Deklarate paralajmeruese
- Identifikimi i furnizuesit
- Personi i kontaktit
- Adresa
- Numri i telefonit dhe celularit

- Madhësi minimale duhettëjetë (gjerësi x lartësi) 21 cm x 14 cm (A5). Etiketaduhettëjetë në gjuhën shqipe dhe angleze.



*Infektuese
Infectious*

Fjala sinjalizuese: RREZIK
Signalword: DANGER
Shprehja e rrezikshmerise: mund të shkaktoje infeksion
Hazard Statement: may cause infection

Nr. i UNI /-UN-Number: 3291
Klasa/Class: 6.2
Katalogu i Mbetjeve:
Waste Catalogue: 18.01.03*
Nr. i EINECSI /EINECS Nr.:
R - Frasa I A-Phrase: R21
S - Frasa I S-Phrase: S1/4/24/35/36/37/431/60

Shprehja parandaluese / Precautionary Statement:

Identiteti i furnizuesit/Supplier

Identification: Personi i Kontaktit/

Contact Person:

Adresa/Address:

Numri i Telefonit/ Tel Number:

Etiketa e "Destinacionit dhe e Deklarimeve"

Cdo kosh i ambalazhuar, i mbyllur dhe vulosur, duhet te identifikohet me nje etikete qe duhet te vendoset ne unazen e vules dhe qe tregon:

- Vendndodhjen;*
- Gjendjen e ngurte ose te lenget;*
- Llojin e mbetjes se rrezikshme;*
- Daten e grumbullimit;*
- Numrin e koshit ose ambalazhimit;*
- Sasine ne kg ose litra;*
- Nenshkrimin e punonjesit te grumbullimit.*

Ashtu sic kemi parashtruar dhe ne ankimin drejtuar Autoritetit Kontraktor ne momentin e dorezimit te mostrave prane Spitalit Rajonal Lezhe me daten 26/04/2021 ora 09:00, jane paraqitur vetem dy Operatore Ekonomik, MEDI-TEL shpk dhe VALE Recycling. Nga ana e shoqerise :MEDI-TEL shpk dorezimin e mostrave e ka bere Administratori i shoqerise Z. Ervin Kristo dhe ne prani te perfaqesueve te Spitalit si dhe te perfaqesuesit te shoqerise VALE Recycling.

Perfaqesuesi yne ka bere me dije se kontenitoret qe shoqeria VALE Recycling ka paraqitur per kete procedure nuk i permbushnin standardet/kerkesat e kerkuara ne DST, pasi te gjitha kontenitoret nuk permbushnin Piken 12 e LOTIT 1, te 3.3 Kapaciteti teknik, pasi asnje nga keta kontenitore nuk kishte te stampuar ne gjuhen shqipe dhe angleze asnje etikete. Edhe kontenitoret qe kishin vetem njeran nga etiketat nuk e kishin sipas madhesis se kerkuar ne VKM 798 date 29.09.2010 dhe e ritheksojme se asnje etikete nuk ishte ne gjuhen SHQIPE, kur VKM 798 date 29.09.2010 e kerkon qarte qe etiketat duhet te jene ne gjuhen SHQIP dhe ANGLISHT.

Ne lidhje me pretendimet tona sipas ankeses neane te shkreses Nr.354/2, Prot, date 14.05.2021 Autoriteti Kontraktor nuk merr ne konsiderate ankesen tone duke arsyetuar se:

Ne lidhje me ankimin e Operatorit Ekonomik MEDI - TEL ju sqarojme se : Bazuar ne nenin 27/6 te Vendimit te Keshillit te Ministrave nr.914, date. 29.12 .2014." Per miratimin. e rregullave te prokurimit publik" dhe ne Udhezimin e APP-se Nr.2 Date.02.05.2019. "Mbi procesin e administrimit te mostrave te paraqitura nga Operatoret Ekonomik shihet qarte qe Operatoret Ekonomike mund te marrin dijeni vetem per procesin e Paraqitjes se mostrave dhe jo per procesin e vleresimit tetyre qe eshte nje process i rezervuar dhe i ruajtuar nga konfidencialiteti sipas pikes 5 te Udhezimit te sipercituar. "Mostrat e paraqitura nga ofertuesit duhet te trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet te jene ne administrim dhe ne ruajtje te Autoritetit Kontraktor ." Ne saj te ketij konfidencialiteti

referuar ankeses se Operatorit Ekonomik., mund te themi qe keto mostra jane vleresuar nga KVO si dhe ne kuader te shqyrtimit te ankesese dhe nga KSHA dhe rezultojne sipas kerkesave ligjore, pra kane etiketat ne gjuhen ne madhesine dhe formen e kerkuar. Nga sa me lart ankesa Juaj nuk qendron.

Të nderuar antarë të KPP!

Ky pretendim i AK eshte plotesisht haptazi i paligjshem dhe i njeanshem. Ashtu sic sqaruam me lart ne momentin e paraqitjes se mostrave perfaqesuesi yne ka deklaruar perpara te pranishmeve se kontenitorët që shoqëria VALE recycling ka paraqitur për këtë procedure nuk i përmbush standardet/kërkesat e kërkuara në DST pasi të gjithë kontenitorët e paraqitur nuk përmbushin pikën 12 e Lotiti 1 të 3.3 Kapaciteti Teknik... Nga ana ime si përfaqësues i Meditel është kërkuar që të mbahet një procesverbal por nga ana e AK nuk është mbajtur duke shkelur kështu parimin e transparencës.

Po keshtu veme ne dijeni se e gjithes procedura e kryer nga AK eshte bere ne kundërshtim haptazi me ligjin dhe vete udhezimin e APP-se nr.2, date 02.05.2019 "Mbi procesin e administrimit te mostrave te paraqitura nga Operatoret Ekonomike ". Ndryshe nga shprehet AK ne kthimin pergjigje te ankeses sone vlen te theksojme se ne Udhezimin.2/2019 eshte sanksionuar ne menyre te qarte dhe eksplicite se:

- *3. Duke qene se dorëzimi i mostrave behet prane autoritetit kontraktor, në bazë të parashikimeve të nenit 12 të LPP autoriteti kontraktor duhet të mbajë procesverbale për të administruar procesin e paraqitjes së mostrave me qëllim sigurimin e transparencës dhe integritetit të këtij procesi.*

Ne kete kuptim, ne rastin kur autoriteti kontraktor vlereson si te nevojshem dorëzimin e mostrave, ne daten dhe oren e percaktuar ne dokumentet e tenderit per paraqitjen e tyre nga ofertuesit, duhet te mbahet nje procesverbal, i cili dokumenton procesin e paraqitjes se mostrave. Ne kete rast mbajtja e procesverbalit i shërben vetëm procesit të evidentimit dhe ruajtjes së mostrave deri në momentin e kthimit të tyre tek ofertuesit. Nje kopje e ketij procesverbali i mbajtur me ofertuesin/ofertuesit e pranishem duhet ti vihet ne dispozicion ketyre te fundit.

- *4. Procesverbali i paraqitjes së mostrave të mallit i cili administrohet në dosjen e tenderit duhet të pasqyrojë çdo hap të ndjekur nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ose anetaret e komisionit te prokurimit me vlere te vogel, në lidhje me administrimin e tyre.*

Sa me sipër pretendimi AK se Operatoret Ekonomikë mund te marrin dijeni vetem per procesin e Paraqitjes se mostrave dhe jo per procesin e vleresimit tetyre qe eshte nje process i rezervuar dhe i ruajtuar nga konfidencialiteti sipas pikes 5 te Udhezimit te sipercituar për vetë faktin se në momentin e dorëzimit shikohet transparenca dhe integriteti i procesit nga vetë AK dhe prandaj duhet të mbahej procesverbali gjë e cila nuk është bërë në rastin konkret duke vepruar në kundërshtim me ligjin.

- *Gjithashtu mostrat e paraqitura nga OE VALE Recycling nuk ishin të mbyllura dhe me shënimin përkatës sipas LPP:*

...mostrat duhet të dorëzohen të mbyllura me ngjitëse në zarf/a ose kuti jotransparente të vulosur/a, mbi të cilin/at të shënohet: “Mos e hapni me përjashtim të rasteve kur është i pranishëm Komisioni I Vlerësimit të Ofertave të procedurës së prokurimit..... dhe jo para dates____, ora____. Së bashku me mostrat ofertuesi duhet të japë dhe një shkresë të vulosur dhe firmosur ku të listohen mostrat që ndodhen në zarf/kuti.

Në këtë mënyrë përveçse mostrat e dorëzuara nuk i përmbushin kriteret e kërkuara por edhe verifikimi i tyre që nuk ishin me etiketat përkatëse ishte shumë i lehtë dhe i dallueshëm.

Neni 2 te LPP që përcakton "Përzgjedhja e fituesve të kontratave publike realizohet në përputhje me këto parime të përgjithshme:

- a) MOSDISKRIMINIM DHE TRAJTIM I BARABARTE I OFERTUESVE OSE KANDIDATEVE;
- b) TRANSPARENCE NE PROCEDURAT E PROKURIMIT;
- c) BARAZI NE TRAJTIMIN E KERKESAVE DHE TE DETYRIMEVE, QE U NGARKOHEN OFERTUESVE OSE KANDIDATËVE.

Në rastin objekt ankimi, vlerësimi i ofertave i bërë në mënyrë të njëanshme cënon parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit parashikuar nga neni 2 I lex specialis atë të barazisë në trajtimin e kërkesave dhe detyrimeve që i ngarkohen ofertesve.

Për të gjitha sa më sipër kërkojmë:

1. Përzullimin e procedurës së prokurimit objekt ankimi dhe të shqyrtohet ankesa jone.
2. Të anulohet Vendimi i Autoritetit Kontraktor që ka kualifikuar shoqërinë OE Vale Recycling dhe të bëhet skualifikimi i saj për Loti 1-“Instrumente të mprehta” me vlerë fondi limit 7,852, 000.00 lekë për shkak se nuk plotëson DST.
3. Shpalljen fitues shoqërinë Medi-Tel SHPK

II.8. Nëpërmjet shkresës nr.392/1 prot., datë 31.05.2021 protokolluar me tonën me nr. 864/2 prot., datë 31.05.2021 me objekt “Kthim-përgjigje”, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumenteve të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Medi-Tel” SHPK mbi kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “V.A.L.E Recycling” SHPK në procedurën e prokurimit objekt ankimi me arsyetimin se: “ - Te gjithë kontenitoret nuk përmbushnin pikën 12 e LOTIT 1, te 3.3 Kapaciteti teknik, pasi asnjë nga këta kontenitoret nuk kishte të stampuar në

gjuhen shqipe dhe angleze asnje etikete. Edhe kontenitoret qe kishin vetem njerën nga etiketat nuk e kishin sipas madhësisë së kërkuar në VKM 798 datë 29.09.2010 dhe e rritësojme së asnje etikete nuk ishte në gjuhën SHQIPE, kur VKM 798 datë 29.09.2010 e kërkon qartë që etiketat duhet të jenë në gjuhën SHQIP dhe ANGLISHT” Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Në shtojcën 8 të modifikuar të dokumenteve të tenderit, Loti 1 “Instrumente të mprehta”, “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, 3.3 “kapaciteti teknik” pika 11 është parashikuar plotësimi i kërkesës si më poshtë:

11. Operatori duhet të furnizojë me kontenitore sipas standardeve dhe kërkesave të VKM Nr. 798 datë 29.09.2010 “Për administrimin e mbetjeve spitalore” pika 8/4 dhe 8/5 të kreut III. Për të provuar plotësimin e këtij kriteri, operatori duhet të paraqesë në ambientet e SRL-se ne datën dhe orën e hapjes së tenderit nga një mostër të paketimeve:

a. Për mbetjet e mprehta Kontenitor Plastik me 1 përdorim (rreth 3 L dhe rreth 5L)_ loti 1

b. Për mbetjet me potencial infektues Kontenitor Kartoni me Qese të Verdhe me 1 përdorim (rreth 40L dhe rreth 60L)_ loti 1

Certifikatën e aprovimit dhe faturat e zhdoganimit ose të blerjes të tipit të ambalazhit për secilin lloj kontenitori.

III.1.2. Në shtojcën 9 të dokumenteve të tenderit “Specifikimet teknike”, Loti 1, “Instrumente të mprehta” përcaktohen specifikimet teknike si më poshtë:

18 01 01. Instrumente të mprehta (përveç 18 01 03)

Instrumente të mprehta të përdorura, si për shembull: age, shiringa, bisturi, brisqe, pajisje të përziera, qelqe të thyera dhe të ndotura, tuba reanimacioni dhe materiale të tjera të ngjashme. Zona ku ushtrohet kujdesi shëndetësor, salla operacioni, laboratorë dhe qendra kërkimore, banka gjaku, qendra për mbledhjen dhe transfuzionin e gjakut, qendra dialize.

- ✓ *Operatori Ekonomik fitues, në momentin e lidhjes së kontratës e në vazhdim, duhet të pajisë Institucionin me kontejnere perkates, sipas mbetjeve (plastik dhe kartoni), të certifikuara, në të cilat do të grumbullohen mbetjet spitalore, kontejneret duhet të kenë të vendosura etiketat sipas shtojcës 2A dhe 2B të Vendimit nr. 798 dt. 29/09.2010 “Për miratimin e rregullores” Për administrimin e mbetjeve spitalore”.*

.....

III.1.3. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimmues se mostrat e paraqitura nga operatori ekonomik “V.A.L.E Recycling” SHPK nuk përmbushin Piken 12 të LOTIT 1, 3.3 Kapaciteti teknik pasi asnjë nga këta kontenitorë nuk kishte të stampuar në gjuhën shqipe asnje etikete dhe kontenitoret që kishin vetëm një nga etiketat nuk e kishin sipas madhësisë së kërkuar në VKM 798 datë 29.09.2010, në kuadër të shqyrtimit të plotë të ankesës së operatorit ekonomik “Medi-Tel” SHPK, Komisioni i Prokurimit Publik me vendimin K.P.P

864/1, datë 25.05.2021 për pezullimin e procedurës së prokurimit objekt ankimi i ka kërkuar Spitalit Rajonal Lezhë edhe paraqitjen e mostrave të operatorit ekonomik “V.A.L.E Recycling” SHPK për procedurën e mësipërme të prokurimit.

III.1.4. Me shkresën nr.392/1 prot, datë 31.05.2021 të Spitalit Rajonal Lezhë bashkë me informacionin e hollësishëm mbi procedurën e mësipërme të prokurimit janë depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik, edhe mostrat e dorëzuara nga operatori ekonomik “V.A.L.E” SHPK për këtë procedurë prokurimi.

III.1.5. Në nenin 46, pika 1, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.”*

Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcakohet se: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit...”*

III.1.6. Në nenin 27 pika 6 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, “Kontratat e Mallrave” parashikohet shprehimisht se:

Autoriteti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

- a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit kontraktor. Ato i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, 30 (tridhjetë) ditë pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit;*
- b) dëshminë e origjinalitetit të mostrave, përshkrimin dhe/ose fotografitë apo katalogjet teknike;dhe/ose*
- c) dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.*

III.1.7. Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Gjithashtu një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin

e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 2 i ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar. Zbatimi i parimit të transparencës barazisë, dhe mosdiskriminimit janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë se operatorët ekonomikë duhej të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato.

III.1.8. Referuar kriterit të veçantë të kualifikimit rezulton se është kërkuar shprehimisht që *Operatori duhet të furnizojë me kontenitore sipas standardeve dhe kërkesave të VKM Nr. 798 date 29.09.2010 “Për administrimin e mbetjeve spitalore” pika 8/4 dhe 8/5 të kreut III. Per të provuar plotësimin e këtij kriteri, operatori duhet të paraqesë në ambientet e SRL-se në datën dhe orën e hapjes së tenderit nga një mostër të paketimeve: 1.Per mbetjet e mprehta Kontenitor Plastik me 1 përdorim (rreth 3 L dhe rreth 5L) loti; 2.Per mbetjet me potencial infektues Kontenitor Kartoni me Qese të Verdhe me 1 përdorim (rreth 40L dhe rreth 60L) loti 1.*

III.1.9. Autoriteti kontraktor në kthimin e përgjigjes lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimes argumenton si vijon: “ “[.....] Pasi u njohën me ankesën Tuaj të datës 12.05.2021, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave arsyetoi si më poshtë:

1. Në lidhje me ankimin e Operatorit Ekonomik MEDI-TEL për skualifikimin e tij për mosplotësim të kriterit 2.4.5 të Shtojcës 7:

Bazuar në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Per Prokurimin Publik", i ndryshuar, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 "Per miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.798 datë 29.09.2010 "Per administrimin e mbetjeve spitalore" si dhe Udhezuesin Kombëtar "Administrimi i Sigurtë i Mbetjeve Spitalore", ju sqarojme se :

*Bazuar në nenin 27/6 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 "Per miratimin e rregullave të prokurimit publik" dhe në Udhezimin APP-se Nr.2 Date 02.05.2019 "Mbi procesin e administrimit të mostrave të paraqitura nga Operatoret Ekonomike", shihet qartë që Operatoret Ekonomikë mund të marrin dëgjime vetëm për procesin e paraqitjes së mostrave dhe jo për procesin e vlerësimit të tyre që është një proces i rezervuar dhe i ruajtur nga konfidencialiteti sipas pikës 5 të Udhezimit të sipërcituar "Mostrat e paraqitura nga ofertuesit duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në administrim dhe në ruajtje të Autoritetit Kontraktor". Në sajë të këtij konfidencialiteti, referuar ankesës së Operatorit Ekonomik, mund të themi që këto mostra janë vlerësuar nga KVO si dhe në kuadër të shqyrtimit të ankesës edhe nga KSHA, dhe rezultojnë sipas kërkesave ligjore, pra kanë etiketat në gjuhën shqipe, në madhësinë dhe formën e kërkuar.
Nga sa më lart ankesa Juaj nuk qendron.”*

III.1.10. Referuar pretendimeve të ankimesit si dhe nga verifikimi i mostrave të dorëzuar nga operatori ekonomik “V.A.L.E Recycling” SHPK, KPP konstatoi se ky i fundit ka paraqitur nga një mostër për secilin nga artikujt e kërkuar në pikën 3.3. të “Kapacitetit teknik” pika 11 të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit. Nga verifikimi i mostrave të dorëzuara nga operatori ekonomik “V.A.L.E Recycling” SHPK vërehet se ato nuk i përmbushin të gjitha kërkesat e

kriterit të veçantë të kualifikimit të përcaktuar në pikën 3.3 të kapacitetit teknik pika 11. Konkretisht etiketat në formën e rombit të mostrave të dorëzuara janë në dy gjuhë shqip dhe anglisht siç përcaktohet në shtojcën 2.A të VKM Nr. 798 date 29.09.2010 "Per administrimin e mbetjeve spitalore" por ato janë në përmasa më të vogla se sa përcakton shtojca 2.A e aktit nënligjor të sipërpërmendur për të cilën përmasat minimale duhet të jenë (gjerësi x lartësi) 14 cm x 14 cm. Në mënyrë specifike: për kontejnitorin prej 5 Lt etiketa romb ka këto përmasa: (gjerësi x lartësi) 11 cm x 10.6 cm; për kontejnitorin prej 3 Lt etiketa romb ka këto përmasa: (gjerësi x lartësi) 11 cm x 10.7 cm; për kontejnitorin e kartonit prej 40 Lt etiketa romb ka këto përmasa: (gjerësi x lartësi) 9 cm x 9 cm; për kontejnitorin prej 60 Lt etiketa romb ka këto përmasa: (gjerësi x lartësi) 10.5 cm x 10.5 cm. Po ashtu etiketa e vendosur në pjesën e përparme të kontejnitorëve 3 L dhe 5L janë në gjuhët shqip dhe anglisht sipas parashikimeve ligjore por nuk përmbushin kriteret minimale të gjerësisë pasi kjo e fundit është në përmasa më të vogla se ajo çfarë parashikon VKM Nr. 798 datë 29.09.2010 "Per administrimin e mbetjeve spitalore" ku për këtë etiketë përmasat minimale duhet të jenë (gjerësi x lartësi) 14 cm x 5 cm. Në mënyrë specifike: për kontejnitorin prej 5 Lt përmasat për këtë etiketë janë (gjerësi x lartësi) 11 cm x 10.6 cm; për kontejnitorin prej 3 Lt përmasat për këtë etiketë janë (gjerësi x lartësi) 11 cm x 10.7 cm. Për të vazhduar më tej, etiketa përshkruese e vendosur në mostrat e paraqitura të kontejnitorëve të kartonit nuk është në përputhje me aktin nënligjor të mësipërm pasi përmasat minimale të gjerësisë së saj janë më të vogla se sa parashikohet, ku për këtë etiketë përmasat minimale duhet të jenë (gjerësi x lartësi) 21 cm x 14 cm. Në mënyrë specifike: për kontejnitorin prej 60 Lt përmasat e kësaj etikete janë: (gjerësi x lartësi) 16.2 cm x lartësi 23.2 cm; për kontejnitorin prej 40 Lt përmasat e kësaj etikete janë: (gjerësi x lartësi) 16.2 cm x lartësi 23.2 cm. Në këtë kushte KPP gjykon se autoriteti kontraktor nuk ka vepruar drejt duke i konsideruar të rregullta mostrat e paraqitura nga operatori ekonomik "V.A.L.E Recycling" SHPK pasi ato nuk janë konform kriterëve të veçanta të kualifikimit dhe specifikimeve teknike të përcaktuara në procedurën e prokurimit objekt ankimi. Mostra, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të siguruar produktin e kërkuar nga autoriteti kontraktor në përputhje me kriteret e vecanta të kualifikimit dhe specifikimet teknike të kërkuara. Në rastin konkret mostrat e dorëzuara nga operatori ekonomik "V.A.L.E Recycling" SHPK nuk janë në përputhje me atë që ka kërkuar autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit.

Sa më lart pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimet e tjera të operatorit ekonomik ankimues për veprimet e autoritetit kontraktor mbi procesin e administrimit të mostrave të operatorit ekonomik "V.A.L.E Recycling" SHPK në procedurën e prokurimit objekt ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se për sa kohë që pretendimi i mësipërm qëndron dhe gjendja faktike dhe juridike e operatorit ekonomik "V.A.L.E Recycling" SHPK pas arsytimit të KPP-së do të ndryshojë duke u skualifikuar si dhe duke përmbushur interesin e ankimuesit, ato nuk do të merren në shqyrtim në respekt të parimit të ekonomisë në shqyrtimin administrativ.

III.3. Për arsytimin më lart, KPP e gjykon të pabazuar vendimin e autoritetit kontraktor për kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik "V.A.L.E Recycling" SHPK dhe ky vendim duhet anuluar si një vendim i dalë në kundërshtim me ligjin për prokurimin publik në kuptim të nenit

64 pika 3 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” të ndryshuar, i cili parashikon shprehimisht se: “3. Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik, kur gjykon se një vendim apo veprim i autoritetit kontraktor ka shkelur ndonjë nga dispozitat e këtij ligji, ka të drejtë:

- a) të nxjerrë një interpretim për rregullat ose parimet ligjore, që duhet të zbatohen për objektin e ankesës;
- b) të anulojë, plotësisht ose pjesërisht, një veprim ose vendim të autoritetit kontraktor, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin. Kjo përfshin edhe të drejtën për të hequr të gjitha ato specifikime teknike ose llojet e tjera të specifikimeve që bien ndesh me këtë ligj;
- c) të udhëzojë autoritetin kontraktor të korrigjojë shkeljet dhe më pas të vazhdojë me procedurën e prokurimit të kontratës;
- ç) të urdhërojë anulimin e procedurave për shpalljen e kontratës fituese.”

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Medi-Tel” SHPK për procedurën e prokurimit me nr. REF-90182-03-17-2021, Loti 1 me objekt “Instrumente të mprehta” me fond limit 7.852.000,00 lekë pa TVSH zhvilluar në datën 26.04.2021 nga Drejtoria e Spitalit Rajonal, Lezhë.
 2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së datë 06.05.2021 mbi kualifikimin e operatorit ekonomik “V.A.L.E Recycling” duke e skualifikuar këta operator ekonomik.
 3. Autoriteti kontraktor, brenda 10 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi, duke dokumentuar veprimet e kryera.
 4. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Medi-Tel” SHPK.
 5. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
 6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr.864 Protokolli, Datë 20.05.2021

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Jonaïd Myzyri